# REPUBLIKA E SHQIPËRISË
# BASHKIA KUÇOVË
# KËSHILLI BASHKIAK

Nr: 4582/1 Prot Dt: 18.12.2025

# VENDIM
## NR. 60 DATË 12.12.2025

# PROGRAMI BUXHETOR AFATMESËM
# 2026 – 2028

# BUXHETI 2026

# PËRMBAJTJA

**BASHKIA KUÇOVE**

**1. HYRJE** ........

1.1 ROLI DHE QËLLIMI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM, SI NJË INSTRUMENT EFEKTIV PLANIFIKIMI NË NIVEL VENDOR ........
1.2 FAZAT E PËRGATITJES DHE MIRATIMIT TË PBA-SË ........

**2. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BASHKISË (1-2 FAQE)** ........

2.1 SITUATA E NJËSISË SË VETËQEVERISJES VENDORE ........
2.2 ÇËSHTJE KRYESORE PËR PROJEKTET DHE POLITIKAT E BASHKISË KUÇOVË ........

**3. ORIENTIMI AFATGJATË I BASHKISË KUÇOVË (1-2 FAQE)** ........

3.1 STRATEGJIA E ZHVILLIMIT AFATGJATË ........
3.2 SFIDAT KRYESORE TË ZHVILLIMIT / PARAQITJA E PROJEKTEVE KRYESORE – ARSYET DHE PËRFITUESIT ........

**4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË KUÇOVË 2026-2028** ........

4.1 TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET PUBLIKE TË BASHKISË KUÇOVË NË VITET 2026-2028 ........
*4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Kuçovë për vitet 2026-2028* ........
*2.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Kuçovë për periudhën 2026-2028* ........
4.2 INVESTIMET PUBLIKE NË NIVEL VENDOR ........

**5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE** ........

*5.1.1 Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit* ........
*5.1.2 Plani i Shpenzimeve të Produkteve të Programit* ........
*5.1.3 Projektet e Investimeve të Programit* ........
*5.1.4 Informacione Bazë mbi Programin* ........

**6. BUXHETI VJETOR** ........

6.1. DOKUMENTACIONI BAZË ........
6.2. DOKUMENTACIONI SHOQËRUES ........

## Lista e Tabelave

*Tabela 1. Informacion Bazë mbi Bashkinë Kuçovë* ........

*Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit* ........
*Tabela 3. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas kategorive ekonomike.* ........
*Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike* ........
*Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)* ........
*Tabela 5. Shpenzimet e Programit sipas Kategorive ekonomike* ........
*Tabela 6. Qëllimet dhe Objektivat e Politikës së Programit* ........
*Tabela 7. Planet e Shpenzimeve të Produkteve të Programit* ........

*Tabela 8. Projektet e Investimeve të Programit* ..........................................................................................
*Tabela 9. Informacione bazë mbi Programit*..............................................................................................

## *Lista e Shkurtimeve*

PBA – Programi Buxhetor Afatmesëm
NJVV – Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
EMP – Ekipi i Menaxhimit të Programit
GMS – Grupi për Menaxhimin Strategjik
MF – Ministria e Financave
FPT – Instrumenti i Planifikimit Financiar
INSTAT – Instituti i Statistikave
PBB – Produkti i Brendshëm Bruto
SMBV – Sistemi i Menaxhimit të Buxhetit Vendor

# 1. HYRJE

**Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm;**

a. Krijimi i një lidhje të drejtpërdrejtë ndërmjet prioriteteve, të shprehura në Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Bashkise Kuçovë, dhe prioriteteve në shpenzime me qëllim shpërndarjen efektive të burimeve në dispozicion.

b. Zgjerimi i vizionit të procesit të buxhetimit duke synuar që programet e shpenzimeve të planifikohen në një periudhë afatmesme (3-vjeçare).

c. Një parashikim më i mirë buxhetor, mbështetur në objektiva dhe prioritete të vendosura për një periudhë tre vjeçare, për të gjitha programet e shpenzimeve.

d. Inkurajimi i efektivitetit, efiçencës dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimin e burimeve.

e. Forcimi i disiplinës fiskale duke mundësuar që shpenzimet publike të planifikohen brënda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal.

## 1.1 Roli dhe Qëllimi i Programit Buxhetor Afatmesëm, si një Instrument Efektiv Planifikimi në Nivel Vendor

Programi Buxhetor Afatmesëm (PBA) është një instrument për prezantimin në mënyrë të integruar e disavjecare të parashikimit të të ardhurave dhe burimeve financiare publike dhe për planifikimin, manaxhimin dhe lëvrimin e shërbimeve publike. Si i tillë, ai është një komponent kryesor i planifikimit kombëtar dhe vendor.

Strategjia Kombëtare e Zhvillimit, Strategjitë Sektoriale dhe Planet e Përgjithshme Vendore shpjegojnë atë që qeveria synon të arrijë në fushat kryesore të ofrimit të shërbimeve, cilat struktura të qeverisë do të përfshihen dhe si do të ndërveprojnë me organizatat e sektorit privat dhe aktorë të tjerë joqeveritarë. Si të tilla, ato përshkruajnë mënyrën sesi qeveria synon të zhvillojë komponentët kryesorë të ofrimit të shërbimeve, investimet kryesore publike që do të kërkojnë dhe implikimet përkatëse për nivelin dhe llojin e shërbimeve publike që do të ofrohen. Aspekti strategjik i këtyre dokumenteve i jep formë kërkesave për shpenzime për investime publike si dhe për ofrimin e shërbimeve gjatë periudhave disavjeçare.

Ashtu si edhe nivelet e tjera të qeverisjes, Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVQV-të) janë përgjegjëse për menaxhimin e fondeve publike. Kjo përfshin mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore dhe menaxhimin e burimeve kombëtare që transferohen në bashki nga qeveria qendrore, disa prej të cilave kushtëzohen për shërbime specifike. Kjo do të thotë se kërkohet një instrument për të projektuar burimet e përgjithshme të disponueshme për shpenzimet vendore, duke përfshirë këtu: grantet, huatë, taksa e tarifat vendore dhe transferime nga qeveria qendrore (të kushtëzuara dhe të pakushtëzuara).

Njësitë e vetëqeverisjes vendore ofrojnë shërbime publike vendore bazuar në kompetencat që u jep ligji. Si rrjedhojë, kjo kërkon një instrument për të lehtësuar dhe menaxhuar mënyrën e përdorimit të burimeve gjithsej, duke përfshirë vendimet për llojin e shpenzimeve (pagat dhe

sigurimet; mallrat dhe shërbimet, interesat e borxhit, ripagimi i huave dhe kështu me radhë), si dhe vendimet strategjike se si do të alokohen burime midis llojeve të ndryshme të shërbimeve publike (sigurisë publike, arsimit, shëndetësisë, punëve publike dhe kështu me radhë).

Procesi i PBA-së, prezanton në mënyrë të integruar informacionin mbi parashikimet e të ardhurave dhe burimeve gjithsej dhe përcakton objektivat përse do të shpenzohen ato, kostot e nevojshme dhe llojin e secilit shërbim që do të ofrohet. Ndër të tjera, kjo përfshin lidhjen e qëllimeve dhe objektivave të bashkisë me qëllime strategjike të përcaktuara në strategjitë lokale dhe kombëtare. Procesi i PBA-së, disiplinon maturinë financiare vendore duke planifikuar shpenzimet publike brenda një kuadri realist financiar vendor. Në të njëjtën kohë, ai synon të garantojë që shërbimet publike vendore plotësojnë nevojat në rritje të banorëve duke treguar se si shpenzimet publike për prioritetet strategjike të zhvillimit të njësisë vendore përkthehen në vendime konkrete për ofrimin e shërbimeve publike vendore, me lidhje të qarta mes politikave vendore dhe prioriteteve vjetore të shpenzimeve.

Në procesin e PBA-së planifikimi dhe buxhetimi vendor afatgjatë e ndihmon njësinë vendore të planifikojë sesi shërbimet publike do të evoluojnë me kalimin e kohës, duke përcaktuar kërkesat disavjeçare të shpenzimeve në fusha të ndryshme të ofrimit të shërbimeve në përputhje jo vetëm me ndryshimet e parashikuara në demografinë, por edhe në përputhje me ndryshimin e nevojave të banorëve të bashkisë. Kombinimi i këtij informacioni me parashikimin për nevojat dhe burimet në dispozicion në të ardhmen, u mundëson njësive vendore që të planifikojnë shërbime publike në mënyrë të qëndrueshme, si dhe të zhvillojnë një kuadër afatmesëm të burimeve si bazë për planifikimin afatmesëm të shpenzimeve.

Gjithashtu, procesi i PBA-së siguron një kornizë për planifikimin e investimeve publike sipas programeve buxhetore duke përfshirë edhe kërkesat për shpenzimeve korente. Kjo siguron një bazë të fortë mbi të cilën mund të merren vendimet për investime, të lidhura me planet strategjike dhe planet afatmesme për zhvillimin e shërbimeve të ndryshme publike që njësia vendore ofron për banorët.

Në mënyrë të përmbledhur Programi Buxhetor Afatmesëm përfshin këto procese:

- prezanton informacionin mbi të ardhurat dhe burimet e disponueshme të bashkisë;
- përkthen vizionin strategjik të NJVQV-së në plane praktike për ofrimin e shërbimeve gjatë një periudhë disavjeçare;
- shpërndan burimet sipas fushave të veçanta të ofrimit të shërbimeve publike,
- përcakton treguesit e performancës në secilën fushë të ofrimit të shërbimeve;
- llogarit kërkesat vjetore të shpenzimeve (korente dhe për investime) në përputhje me objektivat dhe treguesit e performancës për një periudhë disavjeçare; dhe
- përcakton treguesit vjetorë të performancës në përputhje me parashikimet për burimet në dispozicion përgjatë një periudhe disavjeçare.

Në qendër të PBA-së janë dy procese planifikimi dhe buxhetimi që NJVQV-të ndërmarrin për të planifikuar treguesit e performancës dhe shpenzimet afatmesme, si dhe propozimet për buxhetet vjetore:

- Përcaktimi i Qëllimeve dhe Objektivave të Programit (nëpërmjet Rishikimit të Politikës së Programit);
- Planifikimi i Shpenzimeve të Programit (në funksion të ofrimit të shërbimeve).

Procesi i *Rishikimit të Politikës së Programit*, synon të specifikojë qëllimet, objektivat e programit, standardet (ndërkombëtare ose shqiptare), si dhe treguesit e perfomancës të lidhura me ato në terma SMART[1]. Ky informacion konsiston në rezultatet e dëshiruara dhe të matshme nga veprimet e NJVQV-së, të cilat duhet të arrihen në periudhën afatgjatë[2] (Qëllimet e Politikës së Programit), si edhe arritjet e dëshiruara në periudhën tre-vjecare[3], sasitë e produkteve (shërbimeve publike) dhe kostot respektive për arritjen e Objektivave të Programit (që janë hapa të ndërmjetëm për arritjen e një Qëllimi të Politikës së Programit). Të gjitha shpenzimet e NJVQV-së duhet të kontribuojnë në mënyrë direkte dhe integrale në arritjen e Objektivave të Programeve të saj.

Procesi i *Planifikimit të Shpenzimeve të Programit*, synon të përcaktojë sasinë dhe koston e të gjitha shërbimeve publike që NJVQV-ja planifikon të ofrojë gjatë çdo viti të periudhës afatmesme, të shprehura në formën e produkteve SMART të programit. NJVQV-ja, specifikon produkte që sigurojnë arritjen e të gjitha Objektivave të Programit, Qëllimeve të Politikës së Programit si dhe standarteve e treguesve të performancës të lidhura me ato.

Si të tilla, proceset e Rishikimit të Politikës së Programit dhe Planifikimi i Shpenzimeve të Programit përfaqësojnë zemrën e procesit të PBA-së, dhe informacioni i gjeneruar nga këto procese paraqitet në mënyrë të detajuar në Seksionin 3, të dokumentit të PBA-së . Këto qëllime, objektiva, standarde dhe produkte përbëjnë kornizën e performancës për shërbimet publike të NJVQV.

Një element i rëndësishëm i procesit të përgatitjes së PBA-së është specifikimi i Treguesve të Performancës (SMART) për secilën fushë të funksioneve të bashkisë. Kjo përfshin planifikimin dhe kostimin e detajuar të treguesve të performancës brenda secilit funksion të qeverisjes vendore, si dhe prezantimin e këtyre treguesve për miratim tek vendimmarrësit dhe më pas për publikun e gjerë në formën e:

- Produkteve SMART, që specifikojnë në detaje shërbimet publike të planifikuara për t'u ofruar;
- Objektivave SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që specifikojnë arritjet kryesore vjetore nga ofrimi i shërbimeve publike;
- Qëllimeve SMART të Politikës së Programit (dhe treguesve të performancës të lidhura me ato), që bashkia planifikon të arrijë në periudhën afatgjatë;
- Kostot totale të ofrimit të shërbimeve vendore, duke treguar se si njësia vendore planifikon të përdorë burimet në dispozicion;
- Kostot e planifikuara për produktet (shërbimet) individuale, në mënyrë që vendimmarrësit dhe banorët të kuptojnë efikasitetin e planifikuar në ofrimin e shërbimeve të veçanta.

[1] **S**pecifike, **M**atshme, **A**rritshme, **R**ëndësishme, **T**erma **K**ohore.
[2] 'Afatgjatë' I referohet një kohe të specifikuar nga Drejtuesi i Programit, që shkon përtej periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.
[3] Për tu specifikuar për secilin vit të periudhës 3-vjeçare të programit buxhetor afatmesëm.

## 1.2 Fazat e Përgatitjes dhe Miratimit të PBA-së

Udhëzimi Standart[4] i PBA-së, përcakton kërkesat kryesore të procesit të PBA-së për NJVQV, si dhe kërkesat përkatëse për raportim brenda bashkisë apo tek qeveria qendrore. Aspektet kryesore të udhëzimit standart përfshijnë:

- Rolet dhe përgjegjësitë në procesin e përgatitjes së PBA-së për Kryetarin e NJVV-së, Këshillin e NJVQV, GMS, Zyrtarët Autorizues dhe Ekzekutues, Drejtuesit dhe anëtarët e EMP-ve, si dhe MF-së;
- Procedurat, fazat e ndryshme, kalendarin dhe metodologjinë për programimin dhe buxhetimin e bazuar në performancë në përgatitjen e PBA-së;
- Kërkesat e raportimit të programit buxhetor afatmesëm. Më konkretisht, kërkesat për të përgatitur dhe prezantuar: Misionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe strukturën e programeve; Deklaratat e politikës së programeve; Tavanet e njësisë së vetëqeverisjes vendore sipas programeve; Shpenzimet e programeve sipas artikujve; Shpenzimet e programeve sipas produkteve; Projektet me financim të brendshëm; Projektet me financim të huaj; Formatet plotësuese të kërkesave buxhetore; Projekt planin e arkës, i cili dorëzohet në përfundim të fazës së dytë të përgatitjes së kërkesave buxhetore; Raportet e kërkesave shtesë (Kërkesat shtesë sipas produkteve; Kërkesat shtesë sipas artikujve buxhetor)

Udhëzimi Vjetor i PBA-së, përcakton kërkesat specifike për procesin e PBA-së në NJVQV duke përfshirë edhe kërkesa të veçanta për prezantimin e informacionit në këtë dokument. Aspektet kryesore të udhëzimit vjetor për Përgatitjen e PBA-së 2025-2027 përfshijnë:

- Afatet specifike për përgatitjen e dokumentit të PBA-së dhe Informacionin mbi transfertën e pakushtëzuar të përgjithshme dhe atë sektoriale për NJVQV-të;
- Procesin e përgatitjes së PBA, p.sh. proceset për përgatitjen e vlerësimit dhe parashikimit të të ardhurave; Tavaneve të përgatitjes së PBA-së; Organizimit të procesit; Pemës së programeve; Draft dokumentit të PBA-së;
- Sistemin e Menaxhimit të Buxhetit Vendor (SMBV) dhe Manualin e Përdorimit të tij.

Faza 1 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Janarit dhe Qershorit. Kjo është faza strategjike kur merren të gjitha vendimet kryesore për financimin e politikave dhe investimeve të reja. Kjo fazë përmbyllet me përgatitjen e projekt dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVV-ja për të realizuar alokimin strategjik burimeve midis programeve me qëllim përgatitjen e planeve afatmesme të shpenzimeve dhe buxhetit vjetor gjatë fazës teknike të përgatitjes së këtij dokumenti. Në fund të kësaj faze, dokumenti i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi, si dhe dërgohet në MF, brenda datës 1 qershor e cila përgatit komente dhe rekomandiime.

Faza 2 e procesit të PBA-së, zhvillohet midis Korrikut dhe Shtatorit. Kjo është faza teknike gjatë së cilës ekipet e menaxhimit të programeve të njësisë vendore marrin vendimet përfundimtare mbi planet për ofrimin e shërbimeve publike gjatë tre viteve të ardhshme. Gjatë kësaj faze përfshihen vendimet mbi përmbajtjen e projekt buxhetit vjetor që do t'i paraqiten GMS të NJVQV-së. Në përfundim të kësaj faze, përgatitet një version i rishikuar i dokumentit të PBA-së, i cili përdoret nga NJVQV për të vendosur mbi detajet në lidhje me shërbimet publike që do ofrohen si dhe alokimin e shpenzimeve që do të bëhen pjesë e Buxhetit Vjetor.

[4] Udhëzimi Nr. 23, datë 30.07.2018 i Ministrit të Financave dhe Ekonomisë për "Proçedurat Standarte të Përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Dokumenti i Rishikuar i PBA-së bëhet publik në faqen e internetit të NJVQV-ve për qëllime konsultimi.

Faza 3 e procesit të PBA-së dhe Buxhetit Vjetor përshkon periudhën nga tetori deri në muajin Dhjetor kur NJVQV-ja, merret me finalizimin e dokumentit të PBA-së, si dhe miratimin e Buxhetit Vjetor. Gjatë kësaj faze, GMS përgatit një version përfundimtar të PBA-së në përputhje me vendimet e Këshillit të NJVQV-së. Projekt buxheti Vjetor është viti i parë i Projekt Buxhetit Afatmesëm dhe i paraqitet Këshillit të NJVQV-në për miratim (jo më vonë se data 30 nëntor) në një format standard (siç përcaktohet në Udhëzimin e MF). Një version përfundimtar i dokumentit të PBA-së (përfshirë Buxhetin Vjetor) publikohet dhe i vihet në dispozicion publikut të gjerë përmes faqes së internetit të NJVQV-së.

# 2. Vështrim i Përgjithshëm i Bashkisë

## 2.1 Situata e Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore

(Burimi i Informacionit: Plani i Përgjithshëm Vendor)

Misioni i Bashkisë Kuçovë: *Bashkia Kuçovë, përtej qëllimit ekonomik, synon të të krijojë një mjedis shoqëror të shëndetshëm nga i cili përfiton i gjithë komuniteti, ku e mira e përbashkët mbizotëron; ku banorët jetojnë në harmoni me burimet natyrore, hapësirat publike dhe komunitetet e tjera që e rrethojnë, sot e në vazhdim.*

Bashkia Kuçovë është pjesë e qarkut të Beratit, dhe shtrihet në pjesën lindore të Ultësirës Perëndimore, e kufizuar në veri dhe veriperëndim nga zona e Sulovës dhe lumi Devoll, e në jug e jugperëndim nga rrjedha e poshtme e lumit Osum. Me një sipërfaqe prej 160.22 km², territori i Kuçovës së sotme e tejkalon atë të rrethit të Kuçovës, duke përfshirë nën juridiksionin e saj edhe njësinë administrative Lumas, krahas njësive Kuçovë (qendër), Perondi e Kozare. Nga pikëpamja administrative, Kuçova kufizohet me bashkitë Lushnje, Belsh, Cërrik, Gramsh, Berat dhe Dimal.
Kuçova ka një ndër dendësitë më të larta në rajonin e Shqipërisë Qëndrore, me 345 banorë/km². Rreth 80% e kësaj popullsie është vendosur në qytetin e Kuçovës, dhe në njësinë administrative Perondi. Bashkia ka nën administrimin e saj 31 fshatra dhe një qytet.
Sipërfaqja e tokave bujqësore në territorin e bashkisë Kuçovë është 84 km², sipërfaqja më e madhe e të cilës zihet me bimësi natyrore 36,57 km² dhe nga tokë arë e kultivuar me lloje të ndryshme kulturash bujqësore 26,11 km².
Territori i bashkisë ka mbulim të mirë me shërbimin e ujësjellës-kanalizimeve Kuçovë, SHAUK ofron shërbimin në bashkinë Kuçovë dhe njësitë administrative Perondi, Kozarë, ndërsa në njësia administrative Lumas është e pambuluar me shërbimin e ujësjellësit dhe kanalizimeve. Sistemi i furnizimit me ujë të pijshëm UK Kuçovë, furnizohet me ujë nga burimi i Bogovës ashtu si dhe bashkia Berat dhe puset e Fushës së Devollit të cilat furnizojnë me ujë fshatrat Tapi, Drizë, Goraj, Velagosht Gegë dhe Polovinë. Sasia e ujërave që shfrytëzohet nga Burimi i bogovës është mesatarisht 2000l/sek në periudhën e dimrit deri në 350 l/sek në periudhën e verës. Sasia totale (burimi i Bogovës dhe puset e Devollit) mesatare e ujit që shfrytëzohet nga ndërmarrja e ujësjellës – kanalizimeve në bashkisë Kuçovë është 602.5 l/sek.

Bashkia e Kuçovës ka një rrjet të pasur ujor. Në veri-perëndim, për rreth 12.5 km Bashkia përshkohet nga rrjedha e mesme e lumit Devoll i cili bashkohet me Lumin Osum në Arrëz të Urës Vajgurore.

Në Kuçovë ndodhen edhe një numër rezervuarësh ndër të cilët mund të përmendim ujëmbledhësin e Gorajt në pjesën qendrore të bashkisë, ujëmbledhësin e Belesovës në pjesën perëndimore, Ujëmbledhësin ndërmjet fshatrave Gegë dhe Drizë dhe ujëmbledhësin në Salcë-Kozarë. Një sërë përrenjsh të vegjël përshkruajnë pothuajse të gjithë territorin e bashkisë të cilët shërbejnë si burime ushqyese të lumenjve të mëdhenj Osum, e Devoll. Burimet ujore sipërfaqësore janë të rëndësishme për funksionet e tyre të përgjithshme (për ujitje, etj.) dhe mbi të gjitha, ato shërbejnë si burime ushqyese për ujërat nëntokësore jetike për furnizimin me ujë të bashkisë dhe të qyteteve përreth.

Fondi Pyjor e kullosor i Bashkisë së Kuçovës është rreth 4,600 ha dhe gjendet kryesisht në tre komunat e bashkisë që janë Kozare, Perondi dhe Lumas. Komuna Lumas dallohet për sipërfaqen më të madhe të këtij fondi me 3241 ha e ndjekur nga Komuna Perondi me 383 ha dhe Kozarë me 976 ha.

Mjedisi: bashkia ndeshet edhe me sfidat e ndotjes së ajrit dhe të tokës nga industria e naftës dhe burime të tjera të cilat ndikojnë dhe në prodhimin e produkteve bujqësoree blegtorale. Dy nga ndotësit më të përhapur në qytetin e Kuçovës dhe në zonën përreth janë LNP-ja, e cila e ka origjinën nga automjetet që lëvizin në zonë, dhe H2S e cila e ka origjinën nga industria nxjerrëse e naftës që operon në zonë. Ndërkohë, falë industrisë nxjerrëse të naftës, lëndë të tjera ndotëse në ajër të cilat nuk janë mbi normat e lejuara janë edhe oksidet e squfurit, si trajta SO2 dhe benzeni të cilat në të shumtën e rasteve janë mbi normat e lejuara, duke u bërë burim i shumë sëmundje të mushkrive dhe ndotjes së mjedisit. Në këto kushte, Bashkia Kuçovë ka prioritet shtimin e hapsirave të gjelbra pranë industrive ndotëse, si dhe të bashkëpunojë me inspektoriatet shtetërore dhe vendore të mjedisit për kontrollin e vazhdueshëm të zbatimit të kushteve të lejeve mjedisore të bizneseve përpunuese të naftës.

Situata e punësimit në nivel njësie administrative është e diversifikuar për Kuçovën dhe mjaft e orientuar drejt sektorit bujqësor për Kozaren, Perondinë dhe Lumasin. Në Kuçovë, sektori kryesor, me 40% të të punësuarve, janë shërbimet, ndjekur ngushtësisht nga industria (33.5%) dhe më pas tregtia. Sektori i ndërtimit dhe i bujqësisë zë një peshë shumë të ulët (rreth 2% të të punësuarve). Nga njësitë e tjera administrative, Perondia ka një diversifikim disi më të madh, me sektorin e shërbimeve që zë 10% të punësimit. Edhe në Lumas, ky sektor zë një peshë të madhe, 9.6%, në raport me sektorët e tregtisë, industrisë, etj. Gjithsesi në këto njësi, sektori bujqësor është dominues në vlera 71-82%. Kuçova ka një normë 20.5% të papunësisë, përkundrejt normës mesatare kombëtare.

Gjendja e përgjithshme e strehimit në Bashki është problematike. Aktualisht, situata e aplikantëve për strehim social është si më poshtë:

Totali i familjeve që kanë aplikuar për një ndër programet e strehimit social është 129 familje.

Të strehuar në banesa me qera gjatë viteve 2020-2023, janë 10 familje, 2 nga të cilat i përkasin komunitetit Rom.

Rrugët, në Bashkinë Kuçovë rezulton të ketë 314 km rrugë lineare gjithsej, duke përfshirë nga rrugët arteriale, deri te ato peizazhistike e bujqësore. Sipas Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Kuçovë, në qytetin e Kuçovës ka 3.4 km rrugë lineare.

Shpërndarja e rrugëve sipas kategorisë së Kodit Rrugor dhe gjatësisë respektive;

Kategoria e rrugës Gjatësi (km).
Rrugë inter-urbane/rurale kryesore 23
Rrugë inter-urbane/rurale dytësore 37
Rrugë urbane/rurale kryesore 4
Rrugë urbane/rurale dytësore 56
Rrugë lokale 194
Mbetjet Urbane;
Shërbimi i manaxhimit të mbetjeve në territorin e Bashkisë Kuçovë ofrohet nga sipërmarrje private, e cila bën grumbullimin dhe transportin e mbetjeve në venddepozitimin e tyre që ndodhet përgjatë brigjeve të lumit Devoll, në Rreth Tapi, në një largësi 4 km nga qyteti i Kuçovës. Ky venddepozitim funksionon që prej vitit 1987.
Në bashkëpunim me Qeverinë Zvicериane nëpërmjet projektit SECO është bërë i mundur rehabilitimi i plotë i këtij venddepozitimi sipas standarteve dhe legjislacionit në fuqi. Që nga muaji Mars i vitit 2021 ky venddepozitim është marrë në dorëzim nga Bashkia Kuçovë dhe tashmë menaxhohet prej saj.
Gjithashtu kemi një plan operacional të menaxhimit të venddepozitimit të hartuar sipas ligjit me ndihmen e ekspertëve të projektit, i cili po zbatohet për mbarëvajtjen e metejshme.
Venddepozitimi shtrihet në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 18,500 m² duke përfshirë disa nënstruktura të nevojshme për një venddepozitim të kontrolluar. Ai është projektuar dhe ndërtuar si një strukturë e vetme për një volum të përgjithshëm pritës prej 74,000 m³ dhe me të gjithë infrastrukturën e nevojshme shoqëruese duke marrë në konsideratë dy faza (atë të asgjesimit të mbetjeve ekzistuese të hedhura në mënyrë të pakontrolluar (të përfunduar) dhe atë të asgjesimit të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim deri në momentin e ndërtimit të një venddepozitimi të ri). Kjo qasje ka të bëjë me reduktimin e ndotjes së shkaktuar nga hedhja e pakontrolluar e mbetjeve, minimizimin e ndotjes në vijim dhe parandalimin e saj në periudhë afatgjatë. Për të dy këto zona, ose faza asgjesimi mbetjesh të ngurta urbane në mënyrë të kontrolluar është ndërtuar dhe përdoret e njëjta zonë shërbimi, i njëjti sistem për menaxhimin e lëngut kullues nga venddepozitimi dhe për drenazhimin e ujërave atmosferike, si dhe e njëjta metodologji e kapjes së gazit. Strukturat kryesore të marra në konsideratë për të dy fazat janë:
• Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve ekzistuese mbas mbylljes (Faza e parë)
• Zona e asgjesimit të kontrolluar të mbetjeve që do të gjenerohen në vijim (Faza e dytë)
• Sistemi i drenazhimit dhe trajtimit të lëngut kullues nga venddepozitimi
• Sistemi i drenazhimit të ujërave atmosferike
• Sistemi i mbledhjes së gazit
• Porta hyrëse dhe rrethimi
• Shërbime shtesë dhe plotësuese (sheshi që do të përdoret për riciklim, kompostim dhe transferim të mbetjeve në të ardhmen, zyrat, rrugët e brendshme dhe perimetrale, furnizimi me energji, ndriçimi dhe furnizimi me ujë).
Jetëgjatësia e këtij venddepozitimi, specifikisht zona e re e asgjesimit të mbetjeve, do të jetë 5 vjet dhe nëse parashikohen ndërhyrje dytësore (diferencimi, kompostimi), atëherë koha e përdorimit të kësaj infrastrukture rritet.
Menaxhimi i venddepozitimit përfshin proçesin e asgjesimit të mbetjeve, menaxhimit të gazit, lëngut kullues dhe ujërave atmosferike si në fazën operacionale, ashtu edhe post mbylljes së tij, ku të gjitha proçeset së bashku varen nga sjellja e mbetjeve dhe metoda e asgjesimit të tyre.

Për këtë, gjatë kryerjes së proçeseve të punës apo aktiviteteve në zonën e asgjesimit të mbetjeve duhet tëmerren në konsideratë si më poshtë:
• Formimi i një trupi të vetëm mbetjesh, gjeometrikisht uniformë dhe relievit të qendrueshëm gjatë fazës operacionale.
• Kufizimi dhe reduktimi i depërtimit të ujërave atmosferike në trupin e mbetjeve, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në rritjen artificiale të sasisë së lëngut kullues nga venddepozitimi, në proçesin e formimit të gazit dhe qendrueshmërinë e shtresave të kultivimit dhe mbulesës duke shkaktuar efekte negative në mjedis dhe rrjedhimisht rritje të kostove operative.
• Menaxhimi dhe kontrolli korrekt i sistemit të drenazhimit, grumbullimit dhe trajtimit të lëngut kullues nga venddepozitimi deri në shkarkimin fundor.
• Menaxhimi dhe kontrolli i sistemit të kapjes dhe shkarkimit të gazit
• Menaxhimi efikas i burimeve njerëzore dhe teknologjike të disponueshme në objekt Përsa më sipër, detyra e operatorit të menaxhimit të objektit është:
• Të kontrollojë vendosjen e shtresave të mbetjeve, ngjeshjen, mbulimin dhe respektimin e kuotave dhe pjerrësive sipas projektit teknik/vizatimeve
• Të kontrollojë vazhdimisht venddepozitimin dhe sistemin e shkarkimit të ujërave me qëllim garantimin e mirëmbajtjes së rrjetit të shkarkimit dhe rrjeteve të drenazhimit të ujërave sipërfaqësore.
• Të kontrollojë periodikisht mirëmbajtjen e argjinaturave mbajtëse, rrethimit perimetral, portës hyrëse për në kantier dhe të zëvendësojë çdo element të dëmtuar sa më shpejt, në mënyrë që të eleminohet hyrja e kafshëve dhe personave të paautorizuar.
• Të kontrollojë në mënyrë konstante makineritë dhe pajisjet e nevojshme.
• Të kufizojë përhapjen e pluhurave dhe emetimeve të aromave të pakëndshme në mjedis duke marrë këto masa parandaluese:
- kufizimi i sipërfaqes së mbetjeve të ekspozuar ndaj agjentëve atmosferike 8- 25 m² - kompaktim i mbetjeve ditore - mbulimi i mbetjeve me material dheu në fund të ditës ose sipas periodicitetit të përcaktuar, por jo në më pak se 3-4 ditë depozitim
• Të kontrollojë dhe shmangë përhapjen e insekteve dhe parazitëve duke marrë këto masa parandaluese:
- të mos mbeten sipërfaqe të mbetjeve pa mbuluar me material dheu si dhe zona në të cilat konstatohen plasaritje në venddepozitim.
Gjithashtu të respektohet kuota e njëjtë në të gjithë sipërfaqen e venddepozitimit me qëllim evitimin e pellgjeve me ujëra të ndenjur që nxisin shumimin e insekteve
- të ndërhyhet me metoda kontrolli të mizave dhe brejtësve, të realizuara nga personeli i kompanive të specializuara nën mbikëqyrjen e operatorit të venddepozitimit
- të ruajë pjerrësinë e faqes ballore të mbetjeve për të nxitur rrjedhjen e ujit të shiut dhe për të shmangur krijimin e pellgjeve të përkohshëm, të cilët mund të destabilizojnë mbetjet dhe të pengojnë funksionimin e duhur të përditshëm të mjeteve që operojnë në venddepozitim
- të minimizojë sipërfaqen e pambuluar të mbetjeve për të reduktuar volumin e ujit në shtresat fundore të venddepozitimit.

**Shërbimi parësor:**

Në bashkinë Kuçovë gjenden 20 institucione shëndetësore, nga të cilat 1 spital (në qytetin e Kuçovës), 6 qendra shëndetësore, 7 ambulanca konsultore, 3 shërbime dentare dhe 9 farmaci. Kërkohet të shtohet një qendër shëndetësore në njësinë Perondi dhe 2-3 qendra shëndetësore,

ose ambulanca konsultore në njësinë Kuçovë, për të përmbushur standardet e kërkuara të sigurimit të shërbimit parësor.
Arsimi: një vëzhgim i përgjithshëm i objekteve arsimore sugjeron se përgjithësisht, gjendja e tyre është mesatare, me nevojë për rikonstruksione të pjesshme. Të gjitha shkollat kanë nevojë për pajisje mësimore dhe laboratorike, dhe në 45% të rasteve rruga për në to është e paasfaltuar. Vetëm 60% e kopshteve janë të pajisura me terrene sportive.
Sa i takon shkollave të mesme, pjesa më e madhe e tyre kanë akses të mirë, me rrugë të asfaltuar. Janë identifikuar shkollat që janë në gjendje të përgjithshme të degraduar, në nevojë për rikonstruktim tërësor: Shkolla e Zdravës dhe Salcë Kozares, Tapi. Asnjë nga objektet arsimore nuk ka laboratorë dhe të gjithë kanë nevojë për pajisje dhe mjete mësimore. Gjithsesi gjendja e shkollave të mesme është përgjithësisht e mirë, dhe aksesi në to bëhet me rrugë të asfaltuar. Edhe në këto objekte mungojnë tërësisht laboratorët dhe ka nevojë për mjete mësimore, por të gjitha sigurojnë terren sportiv dhe kanë kapacitete optimale klasash, pa konsideruar alternativën e kryerjes së mësimit me dy turne.
Mbrojtja sociale:
Si rezultat i kushteve të jetesës në varfëri ekstreme, ose pjesërisht-ekstreme, mesatarisht në muaj 106 familje përfitojnë ndihmë ekonomike, pagesë paaftësie përfitojnë mesatarisht 970 persona nga buxheti i shtetit dhe rreth 40 familje nga fondet e Bashkisë.
Shërbimet sociale;
Nën administrimin e bashkisë nuk ka qendra sociale për të moshuar, për komunitete të ndjeshme, apo probleme sociale specifike. Këto shërbime mbulohen pjesërisht nga prezenca e një qendre rinore, me bibliotekë të përfshirë, një qëndre kulturore, një qëndre kulturore fëmijësh, qendrës për fëmijët me aftësi ndryshe si dhe ambienteve sportive në stadium dhe në aneksin e fushës së sportit "1 Maji", në qytetin e Kuçovës.

Ky dokument do të jetë baza për përcaktimin e sektorëve prioritarë të zhvillimit dhe identifikimin e prioriteteve të shpërndarjes së burimeve për periudhën: 2026- 2028.

## 2.2 Çështje Kryesore për Projektet dhe Politikat e Bashkisë.

(Burimi i Informationit: PPV)
- Nxitja e punësimit.
- Infrastruktura arsimore.
-Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish zonave industriale.
-Infrastruktura rrugore.
-Migrimi dhe emigrimi.

# 3. Orientimi Afatgjatë i Bashkisë.

## 3.1 Strategjia e Zhvillimit Afatgjatë

(Burimi i Informacionit: PPV)
**Objektivat  e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA):**

**Objektivi strategjik 1**: Zhvillim i qëndrueshëm ekonomiko-social, duke diversifikuar ekonominë urbane dhe duke specializuar ekonominë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore, fuqizimin e kontributit dhe konkurrueshmërisë rajonale të Bashkisë Kuçovë në sektorin industrial, bujqësor e turistik, si dhe rritjen e cilësisë së jetesës për banorët.

**Objektivi strategjik 2**: Zhvillimi i infrastrukturës rajonale, për të përmirësuar aksesin në boshtet kryesore të rajonit, dhe në itineraret turistike, si dhe përmirësimi i situatës lokale të mobilitetit, transportit, dhe shërbimeve të lidhur me infrastrukturën.

**Objektivi strategjik 3**: Menaxhim i qëndrueshëm mjedisor, në mbrojtje të sistemit të ujërave sipërfaqësore e nëntokësore,
duke valorizuar tokën bujqësore dhe elementët e forte natyrorë dhe artificialë, në funksion të zhvillimit të turizmit natyror dhe historiko-kulturor dhe integrimit me potencialet rajonale turistike.

**Objektivi strategjik 4**: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar,
mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor.
Të cilat synohen të arrihen nëpërmjet:

a. Përmirësimit të menaxhimit të shpenzimeve publike dhe rritjes së efiçencës së përdorimit të fondeve buxhetore, që është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
b. Sigurimit të një shpërndarjeje dhe përdorimi me efektivitet të burimeve.
c. Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore, forcimi i lidhjes mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve të fondeve.
d. Përmirësimi i administrimit të taksave dhe financave në zbatim të plotë të legjislacionit dhe përgjegjësisë individuale e kolektive.
e. Rritjes së transparencës dhe pjesëmarrjes së komunitetit në buxhetim dhe llogaridhënie.

## 3.2 Sfidat Kryesore të Zhvillimit / Paraqitja e Projekteve Kryesore – Arsyet dhe Përfituesit

- Nxitja e punësimit.
- Infrastruktura arsimore.
-Rehabilitimi mjedisor dhe rigjenerimi i ish zonave industriale.
-Infrastruktura rrugore.
-Migrimi dhe emigrimi.

# 4. BUXHETI AFATMESËM I BASHKISË KUÇOVË 2026-2028

Tabela 1 paraqet të dhëna bazë mbi bashkinë që përshkruajnë demografinë, sipërfaqen, komunitetin dhe bazën e biznesit, kapacitetin menaxhues, etj.

## 4.1 Të Ardhurat dhe Shpenzimet Publike të Bashkisë Kuçovë në vitet 2026-2028

### 4.1.1 Të ardhurat e parashikuara të Bashkisë Kuçovë për vitet 2026-2028

Ky nënseksion paraqet një përshkrim të secilit prej burimeve kryesore të të ardhurave, duke përfshirë të ardhurat e veta, taksat e ndara, transfertën e përgjithshme të pakushtëzuar dhe transfertat e pakushtëzuara sektoriale, transfertën e kushtëzuar, huamarrjet dhe të ardhurat e trashëguara. Informacioni jepet mbi: të ardhurat faktike të dy viteve të fundit; buxhetin fillestar dhe të pritshmin për vitin korent; dhe parashikimet për tre vitet e ardhshme.

*Tabela 2. Të Ardhurat e Bashkisë sipas Burimit*

#### *4.1.1.1 Të Ardhurat e Veta të Bashkisë Kuçovë*

Ky nënseksion paraqet informacion mbi të ardhurat e veta, përfshirë ato faktike për dy vitet e mëparshme, të pritshmet për vitin aktual dhe parashikimet për periudhën tre-vjeçare të PBA-së. Informacioni mbi supozimet që qëndrojnë në themel të këtyre parashikimeve paraqitet për secilin zë kryesor të të ardhurave të veta.

A. Taksat dhe Tarifat Vendore

A.1 Taksat Vendore

Të ardhurat e programuara për vitin 2026 mbështeten në Paketën Fiskale ”Për Taksat dhe Tarifat Vendore të vitit 2026”, si dhe duke marrë në konsideratë, realizimin e të ardhurave të vitit 2025, për të gjitha Njësite Administrative; Kuçovë, Kozare, Perondi dhe Lumas.
Baza ligjore mbi të cilën është mbështetur hartimi i Programit i të Ardhurave:
- Ligji Nr.9632 date 30.10 2006 “Per Sistemin e Taksave Vendore “ i ndryshuar,
- Ligji Nr.139/2015, date 17.12.2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore” , neni 35 , 36, 37,
- Ligji Nr.68/2017, datë 27.04.2017 ”Për financat e vetëqeverisjes vendore”, kreu III ”Të ardhurat e veta të vetëqeverisjes vendore” , të përcaktuara nga neni 10 deri neni 20,
- Vendimi i Keshillit Bashkiak, VKB nr.52, dt. 30.10.2025 ”Për Miratimin e Taksave dhe Tarifave Vendore për Vitin 2026”.Në zbatim të legjislacionit të mësipërm kemi këto grupe të ardhurash:

I. Të ardhurat tatimore nga taksat dhe tarifat vendore, si:
- taksa vendore mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme dhe transaksionet mbi to,
- taksa vendore mbi veprimtarine ekonomike të biznesit të vogël e të madh,
- taksa vendore mbi veprimtaritë e shërbimeve hoteliere,
- taksa vendore të përkohshme e të tjera të përcaktuara me ligj.

II. Të ardhurat jo-tatimore të cilat përbëhen nga:
- të ardhurat nga tarifat për shërbimet e ndryshme
- te ardhurat nga shitja dhe dhënia me qira
- të ardhura të tjera.

**TË ARDHURAT**

Në analizën e treguesve të të ardhurave janë marrë në konsideratë të gjitha burimet e mundshme.Të ardhurat e Bashkisë janë programuar mbi bazën e realizimit të treguesve të të ardhurave në vite si dhe në bazë te regjistrave të krijuar për të gjitha grupet e tatimpaguesve familjar, të ndërmarrjeve e institucioneve, biznesit të madh , biznesit të vogël të njesive administrative dhe ato të Bashkisë, duke e rritur bazën e taksueshme për çdo vit, për të arketuar sa më shumë të ardhura në mënyrë të tillë që Bashkia të përmbush misionin e saj të përcaktuar në ligjin nr. 139/2015 dt.17/12/2015 ”Për Vetëqeverisjen Vendore”. Të ardhurat për vitin 2026 janë parashikuar në vlerën 267 500 000 leke duke patur parasysh ndryshimin e tarifave ka një rritje, krahasuar me vitin 2025.

Programi i te ardhurave per vitin 2025 ne total dhe sipas njesive administrative është 267 500 000 leke:

| Njësia Administrative | Vlera/leke ne (000) lek | % |
|---|---|---|
| Kuçovë | 218 429 | 81.7 |
| Kozare | 16 279 | 6.1 |
| Perondi | 23 660 | 8.8 |
| Lumas | 9 132 | 3.4 |
| Totali | 267 500 | 100 |

A. TË ARDHURAT TATIMORE

1.TAKSA MBI BIZNESIN E VOGËL

Të ardhurat nga taksa mbi biznesin e vogël ose (tatim fitimi i thjeshtuar), kemi një planifikim 200 000 lekë për vitin 2026.

2. TAKSA MBI PASURINË

Të ardhurat e planifikuara nga kjo taksë në zbatim të ligjit nr. 9632, dt.30.10.2006, i ndryshuar, nenet 22, 23 dhe 23/1, përbëhen nga:

a.Taksa mbi ndërtesat,
b.Taksa mbi tokën bujqësore,
c.Taksa mbi truallin,

a.Taksa mbi ndërtesat,

Planifikimi i të ardhurave nga taksa mbi ndërtesen bazohet në siperfaqen faktike të ndërtesës në metër katror dhe çmimet e referencës për secilën Njësi Administrative

- për çdo ndërtesë banimi për familjarët,
- për çdo ndërtesë ku në të cilën ushtrohet aktivitet tregtar apo shërbimi nga biznesi i madh dhe biznesi i vogël

Në bazë të regjistrave të krijuar për taksën e ndërtesës në katër Njësitë Administrative planifikohen të ardhura si më poshtë vijon:

Në (000) lekë

| Emërtimi | Totali |
|---|---|
| Ndërmarje e Institucione | 125 |
| Familjarët | 5506 |
| Biznesi i Madh | 1146 |
| Biznesi i Vogël | 2910 |
| Totali | 9687 |

b.Taksa mbi tokën bujqësore,

Të ardhurat nga kjo taksë për vitin 2026 do të arkëtohen nga tre Njesitë Administrative në të cilat shtrihet sipërfaqja e tokës bujqësore e ndarë me ligjin nr. 7501 , dt.19/07/1991 në bazë të regjistrave të krijuar duke u bazuar në sipërfaqen e tokës për çdo tatimpagues si dhe në vlerën për çdo kategori të shprehur në ligjin nr.9632 , datë.30.10.2006 ”Për Sistemin e Taksave Vendore”, të ndryshuar . Sipërfaqja e tokës e ndarë me ligjin nr. 7501 datë 19/07/1991 në të tria Njësitë Administrative mbi të cilën llogariten të ardhurat është 6160 Ha , e detajuar sipas Njesive është si më poshtë:

Ne (000)lekë

| Emertimi i Njesise | Numri i taksapaguesve | Sip.tokës bujqësore | Shuma | Në % Ndaj totalit |
|---|---|---|---|---|
| Njësia Kozare | 2023 | 2278 | 4341 | 33.7 |
| Njësia Perondi | 3524 | 2183 | 5639 | 43.8 |
| Njësia Lumas | 1619 | 1702 | 2888 | 22.5 |
| Totali | 7166 | 6163 | 12868 | 100 |

Të ardhurat nga tatimi mbi tokën bujqësore programohen në vleren 12 868 000 lekë, të cilat zënë 4.8 % të totalit të të ardhurave.

c.Taksa mbi truallin,

Në zbatim të Ligjit nr. 9632, dt 30.10.2006 të ndryshuar, taksa mbi truallin (jo hapësirë publike), për vitin 2026, nuk është planifikuar rritje në krahasim me vitin 2025, e strukturuar sipas kategorive: ndërmarrjet, bizneset, dhe familjarët si më poshte vijon:

Tatim mbi truallin ne 000/lekë

| Emërtimi | Totali |
|---|---|
| Ndërmarrje e Institucione | 19000 |
| Familjaret | 410 |
| Biznesi i Madh | 186 |
| Biznesi i Vogel | 70 |
| Totali | 19666 |

3.TAKSA E REGJISTRIMIT TË MJETEVE TË PËRDORURA

Kjo takse, në zbatim të Ligjit nr.9975 dt. 28.07.2008 ”Për Taksat Kombëtare”, vilet nga strukturat e DPSHTRR-Berat dhe te ardhurat nga kjo taksë derdhen në favor të Bashkisë,ku në zbatim të këtij ligji Bashkia përfiton 25 % te shumës së arkëtuar. Të Ardhurat e programuara nga kjo taksë për vitin 2026, bazuar në ecurine e arkëtimit të kësaj takse në vitin 2025, do të jenë në masën 20 000 000 lekë.

4.TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Të ardhurat nga taksa e ndikimit në infrastrukturë e cila përbëhet nga lejet për ndërtimet e reja dhe legalizimet , do të realizohen në zbatim të ligjit nr.9632 date 30.10 2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, neni 27, të ndryshuar me ligjin 142/2015 datë 17/12/2015 . Mbështetur në realizimin e viteve paraardhëse, faktit të vitit 2025, studimit të tregut të ndërtimeve, bashkëpunimit me ASHK Berat i kërkesave të mundshme për legalizim, kemi planifikuar 1 000 000 lekë për ndërtimet e reja. Ndërsa nga legalizimi i ndërtimeve informale në bazë të zbatimit të proçedurave te legalizimit planifikohen rreth 10 000 000 leke.

5.TAKSË TABELE

Kjo taksë për vitin 2026 në zbatim të ligjit nr. 142/2015, datë 17.12.2015, dhe VKB nr 52 datë 30.10.2025, do të aplikohet për çdo subjekt tregtar apo institucione në vlerën 120 lekë/vit.

## B. TË ARDHURAT NGA TARIFAT

### 1. TARIFA PËR ZËNIEN E HAPËSIRËS PUBLIKE

Në zbatim të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006, neni 32 të ndryshuar me Ligjin nr. 142/2015,dt 17.12.2015, kjo tarifë, është percaktuar që niveli i kësaj tarife për Njësinë Administrative Kuçovë të jetë 90 lekë/m²/muaj, kurse për njësitë e tjera administrative niveli i saj të jetë 55 lekë/m²/muaj dhe nje kohe perdorimi me 8 muaj ne vit ne baze te VKB nr. 52, date 30.10.2025 "Paketa Fiskale 2025".

Për vitin 2025, nga tarifa e zënies së hapësirës publikë jane programuar te ardhura me vleren 11 175 000 leke. Duke u bazuar ne kontratat qe jane lidhur me subjektet e biznesit te madh , te biznesit të vogël per shfrytezimin e hapesires publike , kontratave me ambulantet ne tregun e perqendruar si dhe te ardhurat qe na vijne nga tregu i lire, sipas struktures se subjekteve, jane planifikuar:

Tarifa e zenies se hapesires publike

ne 000/lekë

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Biznesi i Madh | 20 |
| Biznesi i Vogël | 1080 |
| Tregu i përqendruar | 7468 |
| Tregu i lirë | 1960 |
| Totali | 10528 |

Për vitin 2026, programohen nga kjo tarifë të ardhura në masën 10 528 000 lekë në vit.

### 2. TARIFA PËR LEJET E TRANSPORTIT DHE PARKIMI

Këto të ardhura sigurohen nga mjetet e Transportit Mall dhe Taksi të cilet pajisen me Leje Transporti dhe çertifikata vjetore pranë Drejtorisë së Shërbimeve Publike& Transportit në Bashki. Për vitin 2026 janë programuar 288 280 lekë nga Tarifa për Leje Transporti dhe 500,000 lekë nga Tarifa e Parkimit.

### 3.TARIFA E PASTRIMIT

Për vitin 2026 të ardhurat nga kjo tarifë janë programuar 49 500 000 lekë, në bazë të strukturës të përfituesve të këtij shërbimi sipas grupimit të bërë në territorin e Bashkisë dhe në Njësitë Administrative ku kryhet ky shërbim . Ne baze te tarifave te miratuara me Paketen Fiskale per vitin 2026, të dhënat e disponuara nga Drejtoria e të Ardhurave për çdo grup përfituesi dhe sipas njësive administrative janë planifikuar të ardhura si më poshtë:

Ne (000) leke

| Emërtimi | Totali |
|---|---|
| Ndërmarrje e Institucione | 20599 |
| Familjarët | 14033 |
| Biznesi i Madh | 9605 |
| Biznesi i Vogël | 5263 |
| **Totali** | **49500** |

Të ardhurat do të realizohen nga agjentët fiskal të caktuar për secilën kategori tatim-paguesish:
A) Tarifa e pastrimit për abonentët familjar Njësia Administrative Kuçovë do të vazhdojnë të arkëtohen nga Agjenti Fiskal UK sh.a, nëpërmjet faturës së ujit të pijshëm;
B) Drejtoria e te Ardhurave per subjektet e biznesit dhe Ndërmarrje&Institucione.

### 4.TARIFA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Për vitin 2026 të ardhurat nga kjo tarifë janë programuar që të jenë 12 628 000 lekë, në bazë të regjistrave të taksapaguesve përfitues, dhe sipas njësive administrative janë planifikuar si më poshtë:

Në (000) lekë

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 597 |
| Familjaret | 7700 |
| Biznesi i Madh | 837 |
| Biznesi i Vogel | 3504 |
| Totali | 12638 |

5.TARIFA PËR MJEDISIN DHE GJELBËRIMIN

Për vitin 2026 të ardhurat nga kjo tarifë janë programuar 13 515 000 lekë, shërbimi i Gjelberimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ofrohet vetëm në Njësinë Administrative Kuçovë në baze të regjistrit të taksapaguesve sipas grupeve paraqitet si më poshtë:

Ne (000) leke

| Emertimi | Totali |
|---|---|
| Ndermarje e Institucione | 7958 |
| Familjaret | 3115 |
| Biznesi i Madh | 539 |
| Biznesi i Vogel | 1903 |
| Totali | 13515 |

-Në programimin e të ardhurave për vitin 2026, një peshë specifike zënë të ardhurat nga dhënia me qira të tokës bujqësore e pandarë nga ligji 7501, datë 19/07/1991, në 1428 ha, në vlerën vjetore prej 2 640 000 lekë, sipas kontratave të përdorimit për 99 vjet, lidhur këto kontrata me Njësitë Administrative respektive, Perondi dhe Lumas.
-Po kështu dhe nga hapësira ligjore që jep ligji nr. 68/2017, datë 27/04/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" , neni 14 "Tarifat vendore", gërma ç, do të aplikohet një tarife e shërbimit për mirëmbajtje të rrjetit të kullimit e vaditjes, dhe do të strukturohet mundësimi i arkëtimit maksimal nga këto tarifa
Tarifa për mirëmbajtjen e Sistemit Arsimor, për përmirësim të shërbimit që ofrohet në sistemin arsimor, që administrohet nga bashkia, dhe vlera e arkëtuar e kësaj tarife do të shkojë e gjitha për buxhetin e mirëmbajtjes së këtij sistemi. E ardhura e programuar nga kjo tarife do të jetë 3 111 000 lekë për vitin 2026.
- Në buxhetin e të ardhurave për vitin 2026, krahas treguesve të analizuar me sipër në përbërjen e tij do të jenë dhe të ardhurat që vijnë nga shërbimet që ofron Bashkia Kuçovë, për frekuentimin e femijëve në kopshtet e çerdhet e të tjera shërbime.

### *4.1.1.3 Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme*

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar e përgjithshme për periudhën afatmesme që i kalojnë pushtetit vendor komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

### *4.1.1.4 Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale*

Të ardhurat nga transferta e pakushtëzuar sektoriale për periudhën afatmesme komunikohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë përmes Udhëzimit Vjetor dhe atij Plotësues të Përgatitjes së PBA-së.

### 1.1.2 Plani i Shpenzimeve të Bashkisë Kuçovë për periudhën 2026-2028.

Tabela 3, paraqet shpenzimet faktike, të buxhetuara dhe të planifikuara të Bashkisë mbi baza vjetore për secilën kategori ekonomike të shpenzimeve.

*Tabela 4. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programit dhe kategorive ekonomike*
***RAPORTI PBA5: SHPENZIMET SIPAS PROGRAMIT DHE KLASIFIKIMIT EKONOMIK***
*Tabela 5. Shpenzimet e NJVQV sipas Klasifikimit Funksional (Niveli I, II, III i COFOG)*
***RAPORTI PBA4: SHPENZIMET E NJVQV SIPAS KLASIFIKIMIT FUNKSIONAL (NIVELI I, II, III I COFOG)***

# 5. BUXHETI AFATMESËM PËR PROGRAMET BUXHETORE.

| 1 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Krijim i kushteve optimale per zhvillim normal te procesit mesimor ne shkolla. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2025 | | 2029 | |
| | Shërbimi i stafit dhe shërbimet mbështetëse. *(000/leke)* | 174532 | | 176200 | |
| 1.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
| | Shërbime të stafit. *(000/leke)* | 123289 | 129786 | 132164 | 132164 |
| | Objekte arsimore të mirëmbajtura dhe rikonstruktuara. *(Nr. i objekteve)* | 25 | 25 | 25 | 25 |

| | |
|---|---|
| **Standardet e Shërbimeve** të Programit | Kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor, ( shërbime të mirëmbajtjes, ngrohjes, ndriçimit, higjenës etj). Rikonstruksione të objekteve shkollore. |

## Raporti: BV10 - Deklarata e Politikës së Programit

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë
Programi: 09230 - Arsimi i mesëm i përgjithshëm
Buxheti: 2026

| Përshkrimi i Politikës së Programit |
|---|
| • Ndërtim dhe mirëmbajtje e institucioneve shkollore; • Ndërtim, rehabilitim dhe mirëmbajtje e ndërtesave arsimore e sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale; • Shpenzimet për paga për stafin mbështetës. • Administrim,inspektim, organizim ose mbështetje për transport, ushqim, strehim, kujdes mjekësor dhe dentar për fëmijët e shkollave; • Mbështetje për trajnimin e mëtejshëm të mësuesve. • Ndërtim dhe mirëmbajtje konviktesh. |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Ndwrtesa tw mirwmbajtura tw Arsimit te Mesem. | | | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2025 | | 2029 | |
| | Shërbime mbështetëse. *(000/leke)* | 8876 | | 10800 | |
| 1.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Ofrim i shërbimeve mbështetëse. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
| | Kushte optimale për zhvillimin e procesit të mësimdhënies. *(000/leke)* | 8876 | 10575 | 10575 | 10575 |

| | |
|---|---|
| **Standardet e Shërbimeve** të Programit | Kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor, (shërbime të mirëmbajtjes, ngrohjes, ndriçimit, higjenës, furnizim me ujë etj). |

**Raporti: BV10 - Deklarata e Politikës së Programit**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë
Programi: 10430 - Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
Buxheti: 2026

| Përshkrimi i Politikës së Programit |
|---|
| • Përfitime në para dhe në natyrë për familjet që kanë fëmijë në kujdestari; • Përfitime në para, si pagesa për nëna me fëmijë, grante për lindje, përfitime për kujdes për prindërit, pagesa për fëmijët ose familjare, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të mbështetur familjet ose për t'i ndihmuar ato të përballojnë kostot e nevojave specifike (për shembull, familjet me një prind të vetëm ose familjet me fëmijë të paaftë). Mbështetje të pjesshme për faturën e energjisë elektrike dhe konsumin e ujit dhe shërbimet sanitare; • Ndihmë financiare, asistencë për pagesën e një kujdestareje që kujdeset për fëmijët gjatë ditës; • Strehë dhe ushqim dhënë fëmijëve dhe familjeve në mënyrë të përhershme (jetimore, familje kujdestare etj.); • Mallra dhe shërbime dhënë në shtëpi fëmijëve ose atyre që kujdesen për ta; • Shërbime dhe mallrat e ndryshme dhënë familjeve, të rinjve ose fëmijëve (qendra pushimi ose zbavitjeje); • Administrim, organizim ose mbështetje të skemave të mbrojtjes shoqërore; • Shpenzimet për mbulimin e shërbimit të çerdheve nga njësitë e vetëqeverisjes vendore; • Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë shoqërisht të përjashtuar ose në rrezik për përjashtim shoqëror (si personat në skamje, me fitime të ulëta, imigrantë, indigjenë, refugjatë, abuzues me alkoolin dhe droga, viktima të dhunës kriminale etj.); • Përfitime në para, si kompensim page dhe pagesa të tjera për personat e varfër ose të dobët, për të ndihmuar në lehtësimin e varfërisë ose në situata të vështira; • Përfitime në natyrë, si strehë afatshkurtër dhe afatgjatë dhe vakte ushqimi dhënë personave të varfër dhe të dobët, shërbime dhe mallra për të ndihmuar personat, si këshillim, strehim ditor, ndihmë për të kryer punët e përditshme, ushqim, veshje, lëndë djegëse etj; • Fondet e pushtetit qendror për funksionin e deleguar të ndihmës ekonomike dhe pagesën për personat me aftësi të kufizuar; • Përfitime monetare ose në natyrë, si asistencë për detyrat e përditshme për personat përkohësisht të paaftë për punë për shkak sëmundjeje ose dëmtimi (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.); • Përfitime monetare ose në natyrë për personat që janë plotësisht ose pjesërisht të paaftë të merren me veprimtari ekonomike ose të bëjnë një jetë normale për shkak të një gjymtimi fizik ose mendor; • Përfitime në natyrë, si: vakte ushqimi që u jepen personave të paaftë në ambjente të përshtatshme, ndihmë që u jepet personave të paaftë për t'i ndihmuar në detyrat e përditshme (ndihmë shtëpiake, lehtësi transporti etj.), pagesë ditore për personin që kujdeset për personin e paaftë, trajnim profesional e trajnim tjetër i dhënë për të nxitur rehabilitimin në punë dhe atë shoqëror të personave të paaftë, shërbime dhe përfitime të ndryshme dhënë personave të paaftë, për të marrë pjesë në veprimtari kulturore dhe zbavitëse ose për të udhëtuar apo për të marrë pjesë në jetën e komunitetit; • Administrim, vënie në funksionim ose mbështetje për skema të mbrojtjes shoqërore. • Administimi dhe mirëmbajtja e qendrave rezidenciale për të moshuarit; • Përfitime në para dhe në shërbime kundrejt rreziqeve të lidhura me moshën e tretë (humbje e të ardhurave, mungesë pavarësie në kryerjen e detyrave të përditshme, pjesëmarrje e ulur në jetën shoqërore dhe komunitare etj.); • Administrim dhe organizim ose mbështetje të skemave të tilla të mbrojtjes shoqërore. • Përfitime në para dhe në natyrë për personat që janë të aftë për punë, të disponueshëm për punë, por janë të paaftë të gjejnë punësim të përshtatshëm; • Pagesa për grupe pjesë në forcën e punës që marrin pjesë në skemat e trajnimit që kanë për qëllim të zhvillojnë potencialin e tyre për punësim, kompensime për humbje të punës, pagesa të tjera periodike apo të menjëhershme për të papunët, në veçanti për të papunët afatgjatë; • Përfitime në natyrë, si pagesat për lëvizje dhe zhvendosje; • Trajnim profesional për personat pa punë ose ritrajnim për personat që rrezikojnë të humbin vendin e punës; • Akomodim, ushqim ose veshje dhënë personave të papunë dhe familjeve të tyre; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Mbeshtetje sociale per familje ne nevoje dhe kujdesi per femijet. | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2025 | 2029 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| | Fonde te akorduara per sherbimin social. *(000/leke)* | 41316 | | 41700 | |
| 1.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
| | Shërbim i stafit të kujdesit social. *(Nr. i punonjesve)* | 9932 | 10836 | 10851 | 10851 |
| | Shpenzime për suport të familjeve në nevojë me ndihmë ekonomike. *(Nr. i familjeve)* | 34 | 45 | 46 | 46 |
| | Shpenzime për kujdes ndaj fëmijeve me aftësi ndryshe. *(Nr. i femijeve)* | 5 | 5 | 5 | 5 |
| | Shpenzime për kujdes ndaj fëmijëve në çerdhe. *(Nr. i femijeve)* | 70 | 70 | 70 | 70 |

| | |
|---|---|
| **Standardet e Shërbimeve** të Programit | Mbështetje në natyrë dhe para në dorë për familjet më në nevojë. Shërbim ditor dhe përkujdesje për fëmijet me aftësi ndryshe dhe fëmijët në çerdhe. Asistencë mjeksore për individë të vetmuar. |

**Raporti: BV10 - Deklarata e Politikës së Programit**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë
Programi: 10661 - Strehimi social
Buxheti: 2026

| Përshkrimi i Politikës së Programit |
|---|
| • Përfitime në natyrë për të ndihmuar familjet të përballojnë koston e strehimit; • Ndërtim dhe administrim i banesave për strehimin social, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj; • Pagesa të kryera në mënyrë të përkohshme ose afatgjatë për të ndihmuar qiramarrësit për koston e qirasë; • Administrim i çështjeve dhe shërbimeve të strehimit; promovim, monitorim dhe vlerësim i veprimtarive për zhvillimin e strehimit; • Të ardhura në para për grupe të ndryshme familjarësh dhe individësh në nevojë; • Përfitimet në para, si mbështetje për të ardhurat dhe pagesa të tjera në para për personat e varfër dhe vulnerabël me qëllim uljen e varfërisë ose për të asistuar në situata të vështira; |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 1 | **Qëllimi i Politikës së Programit** | Mbështetje sociale për familje në nevojë. | |
| | **TP për Qëllimin:** | 2025 | 2029 |
| | Fond partneriteti per permiresimin e banesave ekzistuese per komunitete te varfra. *(000/leke)* | 12610 | 6000 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1.1 | **Objektivi i Politikës së Programit** | Objektivi strategjik 4: Mbështetja e komuniteteve të qëndrueshme dhe të shëndetshme, me cilësi jetese të përmirësuar, mundësi më të mira zhvillimi në arsim dhe punësim, dhe nivel më të lartë aksesi në aspektin social-kulturor. | | | |
| | **TP për Objektivin:** | 2025 | 2026 | 2027 | 2028 |
| | Permiresim i banesave ekzistuese per komunitete te varfra. *(000/leke)* | 12610 | 4852 | 5000 | 6000 |

| | |
|---|---|
| **Standardet e Shërbimeve** të Programit | Rehabilitim i banesave të familjeve në nevojë. |

**Raporti: BV11 - Detyrimet e Prapambetura**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: 000 ALL

| NR. | KATEGORIA E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA | 2025 | 2025 | | 2026 | | 2027 | | 2028 | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | STOKU I BORXHIT | AMORTIZIMI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DERI NË FUND TË VITIT | STOKU I BORXHIT | AMORTIZIMI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DERI NË FUND TË VITIT | STOKU I BORXHIT | AMORTIZIMI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DERI NË FUND TË VITIT | STOKU I BORXHIT | AMORTIZIMI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA DERI NË FUND TË VITIT | STOKU I BORXHIT |
| **1** | **SHPENZIME KORRENTE** | 283,600.00 | 283,600.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1.1 | Mallra dhe shërbime | 283,600.00 | 283,600.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1.2 | Paga dhe sigurime | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 1.3 | Të tjera | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| **2** | **SHPENZIME KAPITALE** | 30,079,286.00 | 9,599,182.00 | 20,480,104.00 | 20,480,104.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.1 | Insitucione buxhetore | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 2.2 | Subjekte private | 30,079,286.00 | 9,599,182.00 | 20,480,104.00 | 20,480,104.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| **3** | **VENDIME GJYQËSORE** | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 3.1 | Marrëdhënie pune | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 3.2 | Mallra dhe shërbime | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 3.3 | Investime | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| 3.4 | Të tjera | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |
| **TOTALI I DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA** | | 30,362,886.00 | 9,882,782.00 | 20,480,104.00 | 20,480,104.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 | 0.00 |

**Raporti:** **BV13 - Lista e Projekteve Koncensionare / PPP**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| Kodi i Projektit | Emërtimi i Projektit | Kapitujt | Kodi i Programit | Llogaritë Ekonomike | Statusi i Projektit | Burimi i Financimit | Data e Fillimit | Data e Përfundimit | Kosto Totale | Të Mëparshme Fakti | 2023 Fakti | 2024 Fakti | 2025 Buxheti | 2026 Plani | 2027 Plani | 2028 Plani | 2029+ Plani |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

**Raporti:** **BV14 - Shoqëritë Aksionere Publike**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| KF NAFTËTARI | | 2026 |
|---|---|---|
| 1 | **PËRQINDJA E PJESËMARRJES SË NJVQV NË KAPITALIN E SH.A** | 100.00 % |
| **2** | **TË ARDHURA GJITHSEJ** | 0.00 |
| 2.1 | Të ardhura nga shitja (tarifa) | 0.00 |
| **3** | **SUBVENCIONE GJITHSEJ** | 12,000,000.00 |
| 3.1 | Subvencion 1 | 12,000,000.00 |
| 3.2 | Subvencion 2 | 0.00 |
| **4** | **SHPENZIMET GJITHSEJ** | 12,000,000.00 |
| 4.1 | Kosto mallrave & shërbimeve | 12,000,000.00 |
| 4.2 | Shpenzime operative | 0.00 |
| 4.3 | Shpenzime financiare (interesa, etj.) | 0.00 |
| 4.4 | Shpenzime për taksa | 0.00 |
| 4.5 | Shpenzime të tjera | 0.00 |
| 5 | **FITIMI / HUMBJA** | 0.00 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 124 - Bashkia Kuçovë | 62,102,504 | 60,048,941 | 77,095,012 | 62,615,039 | 61,457,028 | 63,755,223 | 81,411,910 | 65,998,749 | 64,626,869 | 70,200,998 | 63,448,158 | 68,696,239 | 801,456,670 |
| 2124001 - Bashkia Kucove (0217) | 34,571,530 | 32,817,117 | 48,386,842 | 26,433,030 | 33,490,074 | 32,327,299 | 48,419,117 | 39,440,925 | 37,710,045 | 41,773,757 | 36,745,334 | 53,345,070 | 465,460,140 |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 16,467,038 | 15,362,075 | 14,932,282 | 14,932,140 | 14,945,346 | 14,933,511 | 14,930,791 | 14,930,791 | 14,750,159 | 15,111,422 | 14,930,792 | 12,004,053 | 178,230,400 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 14,220,200 | 14,971,800 | 14,932,282 | 14,932,140 | 14,181,656 | 6,293,021 | 2,881,050 | 2,881,050 | 2,881,050 | 2,881,050 | 2,881,050 | 2,878,651 | 96,815,000 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 2,246,838 | 390,275 | 0 | 0 | 763,690 | 8,640,490 | 12,049,741 | 12,049,741 | 11,869,109 | 12,230,372 | 12,049,742 | 9,125,402 | 81,415,400 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 7,128,792 | 7,743,222 | 8,801,000 | 7,500,890 | 9,017,212 | 7,365,933 | 11,281,085 | 6,409,448 | 6,204,200 | 11,159,126 | 2,539,446 | 11,705,802 | 96,856,156 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 2,296,792 | 2,231,222 | 2,934,000 | 2,819,090 | 3,564,444 | 4,059,504 | 1,874,650 | 2,484,200 | 2,484,200 | 3,338,750 | 1,541,272 | 974,834 | 30,602,958 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 4,832,000 | 5,512,000 | 5,867,000 | 4,681,800 | 5,452,768 | 3,306,429 | 9,406,435 | 3,925,248 | 3,720,000 | 7,820,376 | 998,174 | 10,730,968 | 66,253,198 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 10,975,700 | 9,711,820 | 24,653,560 | 4,000,000 | 9,527,516 | 10,027,855 | 22,207,241 | 18,100,686 | 16,755,686 | 15,503,209 | 19,275,096 | 29,635,215 | 190,373,584 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 10,975,700 | 9,711,820 | 13,854,278 | 0 | 500,000 | 10,027,855 | 17,355,236 | 18,100,686 | 16,755,686 | 15,503,209 | 19,275,096 | 29,635,215 | 161,694,781 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 10,799,282 | 4,000,000 | 9,027,516 | 0 | 4,852,005 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 28,678,803 |
| Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2124004 - Nd-ja Komunale Banesa (0217) | 8,457,000 | 9,297,300 | 10,138,146 | 17,512,454 | 9,366,700 | 6,947,900 | 11,657,300 | 7,752,300 | 8,697,300 | 7,697,300 | 9,197,300 | 6,089,300 | 112,810,300 |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 4,007,000 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,691,700 | 4,692,900 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,689,300 | 55,619,300 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 4,007,000 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,691,700 | 400,100 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 23,175,700 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 4,292,800 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,692,300 | 4,689,300 | 32,443,600 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 4,450,000 | 4,605,000 | 5,445,846 | 12,820,154 | 4,675,000 | 2,055,000 | 6,965,000 | 3,060,000 | 4,005,000 | 3,005,000 | 2,005,000 | 1,400,000 | 54,491,000 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 2,600,000 | 2,755,000 | 2,755,000 | 2,891,000 | 2,825,000 | 2,055,000 | 3,815,000 | 3,060,000 | 4,005,000 | 3,005,000 | 2,005,000 | 1,400,000 | 33,171,000 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 1,850,000 | 1,850,000 | 2,690,846 | 9,929,154 | 1,850,000 | 0 | 3,150,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 21,320,000 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,500,000 | 0 | 2,700,000 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 200,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 200,000 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 2,500,000 | 0 | 2,500,000 |
| Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| 2124009 - Qendra Ekonomike Arsimit (0217) | 17,763,274 | 16,107,024 | 16,222,524 | 16,842,055 | 16,320,954 | 22,652,524 | 19,142,993 | 17,048,024 | 16,417,024 | 19,127,441 | 16,103,024 | 7,784,869 | 201,531,730 |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 13,480,333 | 12,701,083 | 12,816,583 | 12,696,083 | 12,915,013 | 14,229,083 | 14,226,083 | 14,226,083 | 14,226,083 | 14,226,091 | 13,323,083 | 4,030,929 | 153,096,530 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 13,480,333 | 12,701,083 | 12,696,083 | 12,696,083 | 12,671,013 | 10,762,333 | 10,762,333 | 10,762,333 | 10,762,333 | 10,762,341 | 9,859,333 | 696,329 | 128,611,930 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 120,500 | 0 | 244,000 | 3,466,750 | 3,463,750 | 3,463,750 | 3,463,750 | 3,463,750 | 3,463,750 | 3,334,600 | 24,484,600 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 4,282,941 | 3,405,941 | 3,405,941 | 4,145,972 | 3,405,941 | 7,323,441 | 4,916,910 | 2,821,941 | 2,190,941 | 4,901,350 | 2,779,941 | 3,753,940 | 47,335,200 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 2,904,941 | 2,904,941 | 2,904,941 | 3,304,941 | 2,904,941 | 7,323,441 | 2,504,941 | 1,904,941 | 1,904,941 | 1,976,350 | 1,904,941 | 1,881,659 | 34,325,919 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 1,378,000 | 501,000 | 501,000 | 841,031 | 501,000 | 0 | 2,411,969 | 917,000 | 286,000 | 2,925,000 | 875,000 | 1,872,281 | 13,009,281 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,100,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,100,000 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,100,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 1,100,000 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 2124010 - Kultura Dhe Sporti (0217) | 1,310,700 | 1,827,500 | 2,347,500 | 1,827,500 | 2,279,300 | 1,827,500 | 2,192,500 | 1,757,500 | 1,802,500 | 1,602,500 | 1,402,500 | 1,477,000 | 21,654,500 |
| Shpenzime Personeli (600-601) | 885,700 | 1,352,500 | 1,472,500 | 1,352,500 | 1,349,300 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,227,000 | 15,754,500 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 885,700 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,352,500 | 1,349,300 | 466,800 | 466,800 | 466,800 | 466,800 | 466,800 | 466,800 | 466,800 | 9,560,100 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 120,000 | 0 | 0 | 885,700 | 885,700 | 885,700 | 885,700 | 885,700 | 885,700 | 760,200 | 6,194,400 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602-609, 651, 1661) | 425,000 | 475,000 | 475,000 | 475,000 | 930,000 | 475,000 | 840,000 | 405,000 | 50,000 | 250,000 | 50,000 | 250,000 | 5,100,000 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 425,000 | 475,000 | 475,000 | 475,000 | 475,000 | 475,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 50,000 | 3,100,000 |
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 455,000 | 0 | 790,000 | 355,000 | 0 | 200,000 | 0 | 200,000 | 2,000,000 |
| Shpenzime Kapitale (230-232, 255) | 0 | 0 | 400,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 400,000 | 0 | 0 | 0 | 800,000 |
| 01 - Transferta nga Buxheti Shtetit | 0 | 0 | 400,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 400,000 | 0 | 0 | 0 | 800,000 |

**Raporti:** **BV15 - Plani i Arkës**

NJVQV: 124 - Bashkia Kuçovë

Buxheti: 2026

Vlerat paraqiten në: ALL

| | JANAR | SHKURT | MARS | PRILL | MAJ | QERSHOR | KORRIK | GUSHT | SHTATOR | TETOR | NËNTOR | DHJETOR | TOTALI |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 05 - Nga te Ardhurat e Veta | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Personeli (600-601) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Korrente të Tjera (602 - 604, 606) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Shpenzime Kapitale (230-232) (Huaja) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

**SHTOJCA 3**

**1.Relacion mbi Programin Buxhetor Afatmesëm (PBA):**

a. Administrata dhe sektori mbështetës i Bashkisë,
b. Ndërmarrjet e varësisë.
c. Institucionet e varësisë.

Referuar termave të Ligjit të Ri Organik të Buxhetit, sa më sipër, do të quhen Njësi Shpenzuese.

Si një proces që përfshin Bashkinë dhe të gjitha institucionet në varësi të saj, PBA mbetet një sfidë për përmirësimin e planifikimit dhe përdorimin efektiv të burimeve në dispozicion.

Kështu, çdo program i veçantë do të përfshijë të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij.

Shpenzimet përbëhen nga:

a. Shpenzimet administrative (paga, sigurime dhe shpenzimet operative të Njësive Shpenzuese),
b. Shpenzimet kapitale.

PBA është hartuar në përputhje me legjislacionin përkatës si dhe mbështetet në trajnimet e specialisteve të financës, tatim - taksave, shërbimeve publike, të organizuara nga Ministria e Financave, Instituti i Trajnimit të Administratës Publike, si dhe mbeshtetur në pervojen pozitive të njësive të tjera vendore.

PBA është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe shqetësimeve të drejtpërdrejta të komunitetit, të evidentuara:

- Gjatë punës sonë të përditshme në drejtim të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.
- Nga takimet e Kryetarit të Bashkisë me qytetarë.
- Nga shqetësimet e përcjella nga Komisioni Qytetar.
- Nga kerkesat dhe ankesat e qytetareve adresuar drejtorive përkatëse.
- Dëgjesat publike.

  Kërkesat dhe shqetësimet e marra nga banorët lidhen me:

  -Zgjerimin dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve publike.

  -Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e objekteve shkollore.

  -Mirëmbajtjen dhe rikonstruksionin e rrugëve.

  -Mirëmbajtjen e kanaleve kulluese e ujitëse.

  -Shtimin e fondeve për mbështetjen e shtresave në nevojë.

-Kërkesa për strehim.

Kërkesat e mësipërme janë mbajtur në konsideratë gjatë përgatitjes së buxhetit, brenda mundësive financiare që lejojnë fondet në dispozicion.

**-PLANI FINANCIAR I BASHKISË 2026 – 2028.**

Në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar, të ligjit nr 9632 date 30/10/2006 "Per Sistemin e Taksave Vendore" të ndryshuar, Udhëzimit te Ministrit te Financave nr. 23 datë, 30.07.2018 "Për procedurat standarde të pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", i ndryshuar, Urdhërit të Kryetarit të Bashkise nr. 56 datë, 17.03.2025 u ngrit Grupi per Menaxhimin Strategjik (GMS) dhe urdhër të brendshëm nr. 57 datë, 17.03.2025 për krijimin e EMP, VKB nr. 35 datë 31.05.2017 për krijimin e GSBI.

Përgatitja e Programit Buxhetor Afatmesëm është mbështetur në këto dokumenta:

- Planin e përgjithshëm vendor.
- Planin e Investimeve Kapitale (PIK).
- Plani social vendor.
- Plani vendor i menaxhimit të mbetjeve urbane.
- Dhe ne sugjerimet e dala nga dëgjesat publike të zhvilluara nga gjatë vitit 2025.

Parashikimi i treguesve ekonomiko-financiarë për periudhën 2026-2028 është mbështetur në kriteret e përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8 datë 29.03.2018 "Per procedurat standarde të pergatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm", i ndryshuar si dhe Udhëzimin plotësues të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 8, datë 28.02.2025 " Për përgatitjen e Projekt Buxhetit Afat Mesëm 2026-2028.

Totali i të ardhurave të veta së bashku me transfertën e kushtëzuar e të pakushtëzuar do të mbulojne shpenzimet për funksionet e veta, të përbashkëta e të deleguara, të cilat i ushtron Njësia e Qeverisjes Vendore.

Qëllimi i PBA- 2026-2028 është prezantimi i strategjive të Bashkisë me terma financiarë dhe tendencat e mundshme të të ardhurave dhe shpenzimeve.

E ardhmja kushtëzohet gjithashtu edhe nga faktorë që nuk varen nga Bashkia, por nga Pushteti Qëndror, siç është rasti i ndryshimeve të politikave fiskale në nivel vendor, implementimi i politikave fiskale nacionale me impakt lokal, transferimi i funksioneve të reja pranë pushtetit lokal etj. Për këtë arsye parashikimet rishikohen çdo vit për të reflektuar ndryshimet në politikat sektoriale të Bashkisë, reflektime që pasqyrohen në planin e buxhetit vjetor, të cilat analizohen, diskutohen dhe vendimohen në Këshillin Bashkiak.

**Parashikimi i të ardhurave** ështe bërë duke u bazuar në potencialin e nivelit të gjenerimit të të ardhurave.

Këto parashikime janë të lidhura ngushtë me një sërë faktoresh si:

- Gjendjen në të cilën ndodhet ekonomia e vendit tonë në tërësi si dhe ajo e qytetit tonë në veçanti.
- Trendin rritës në vite të të ardhurave lokale.
- Mos ndryshim të legjislacionit fiskal që është aktualisht në fuqi.
- Masat që do të merren nga administrata tatimore vendore dhe strukturat përgjegjëse të Bashkisë për realizimin e objektivave të Programit.
- Pritshmeria për të ardhmen.

**Çfare parashikojmë në këtë Program Buxhetor Afatmesëm:**

- Ofrim cilësor të shërbimeve publike: pastrim, ndriçim, gjelbërim etj.
- Furnizim normal dhe cilësor me ujë të pijshëm,
- Përmirësim të infrastrukturës në ambjentet mësimore.
- Mbështetje sociale për shtresat në nevojë, gra të dhunuara dhe fëmijët në risk.
- Përmirësim i infrastrukturës rrugore.
- Investime në infrastrukturë.
- Mbështetje për familjet e pastreha.
- Prioritizimin e nevojave për investime dhe sigurimin e burimeve te tjera te financimit, përmes aplikimit me projekte tek donatorë të ndryshëm.

**Planifikimi i shpenzimeve është mbështetur në këto specifika:**

Planifikimi i shpenzimeve është kryer duke u bazuar në ruajtjen e cilësisë së arritur në ofrimin e shërbimeve publike, prioritare për komunitetin si pastrim, ndriçim publik, gjelbërim , mirëmbajtje e varrezave publike, përmirësimi i infrastrukturës shkollore, mirëmbajtje dhe investime në infrastrukturën rrugore, kulturës e sportit etj, si dhe dhe zgjerimin e shërbimeve sipas mundësive financiare të institucionit.

Në mënyrë të veçantë mbetet prioritet i bashkisë gjetja e mundësive financiare alternative në përmirësimin e infrastrukturës shkollore.

**Njësitë shpenzuese:**

- Bashkia Kuçovë,
- Ndërmarja Komunale,
- Qendra Ekonomike e Arsimit,
- Qendra Kulturore,

Gjatë procesit të dëgjesave publike, kërkesat e bëra nga komuniteti janë kryesisht në lidhje me mirëmbajtjen e rrjetit ujitës dhe kullues. Mirëmbajtjen e rrjetit rrugor, shërbimin e ndriçimit rrugor, shërbimin e pastrimit, mirëmbajtjen e objekteve arsimore, mirëmbajtjen e rrugëve të parcelave etj. Këto kërkesa janë marrë në konsideratë gjatë hartimit të PBA.

Buxheti Afatmesëm 2026-2028, është planifikuar sipas funksioneve. Gjithsej 16.

PROGRAMI PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM (01110):

PËR KËSHILLTARËT;

Shpenzimet për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Bashkiak, janë përcaktuar sipas ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore …" i cili përcakton shpërblimin mujor të këshilltarëve në masën 10% të pagës së Kryetarit të Bashkisë".

- Shpërblimi për anëtarët e Këshillit Bashkiak do të jetë 10% e pagës së Kryetarit të Bashkisë.
- Shpërblimi për kryepleqtë do të jetë 10% e pagës së Administratorit të Njësisë Administrative.

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative, transferta tek institucione, fond rezervë dhe investime.

TRANSFERTA;

- Në zbatim ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore …", neni 38 planifikojmë që Këshillit të Qarkut t'i transferohen nga të ardhurat e Bashkisë kuote anëtarësie në shumën 50, 000 lekë.
- Transferime agjentit tatimor Drejtorise Rajonale Tatimore për vjeljen e të ardhurave nga biznesi i vogël në masën 1% të shumës së arkëtuar.
- Transferime agjentit tatimor, U.K.B.K për arkëtimin e tarifave nga familjet në masën 2.5% të shumës së arkëtuar nga tarifat.

PROGRAMI SHËRBIME TË POLICISË VENDORE (03140):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative. (blerje uniformash, dokumentacioni dhe materiale për përdorim policor).

PROGRAMI MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE (03280):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative. Përveç shpenzimeve të planifikuara me fonde të transfertes specifike, parashikohen shpenzime edhe nga fondet e Bashkisë: shpenzimet e sigurimit të jetës dhe shpenzimet për mbrojtjen civile në zërin transferta tek individë. Këto fonde do të përdoren për kompensim të familjeve banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi natyrore dhe Kompensimet do të kryhen në bazë të Vendimeve të Këshillit Bashkiak të miratuar për këtë qëllim.

PROGRAMI SHËRBIMET BUJQËSORE (04220):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative.

PROGRAMI MENAXHIMI I STRUKTURËS SË UJITJES DHE KULLIMIT (04240):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative. Është pakësuar një pozicion pune për punonjësit me kontratë.

PROGRAMI MENAXHIMI I PYJEVE DHE KULLOTAVE (04260):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative. Fondi i pagave për vitin 2026 është më i ulët pasi në vitin 2025 ishte parashikuar fond për shpërblim dalje në pension pleqërie.

PROGRAMI MENAXHIMI I MBETJEVE (05100):

-Shërbimi për pastrimin, grumbullimin, transportin e mbetjeve në venddepozitim parashikohet në buxhetin e Bashkisë në shumën 43,257,748 lekë, sipas kontratës së lidhur.
-Shpenzimet e stafit dhe shpenzime operative për funksionimin normal të venddepozitimit të mbetjeve pakësohen tek Bashkia dhe kalojnë pranë Ndërmarjes Komunale në shumën 6,627,800 lekë.
Shpenzime promovomin e mjedisit parashikohen në shumën 370,000 lekë.

PROGRAMI PLANIFIKIMI URBAN VENDOR (06140):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore. Në vitin 2026 parashikohen më pak fonde për shkak se në këtë program shkurtohet një vend pune.

PROGRAMI SHËRBIME PUBLIKE VENDORE (06260):

Shërbimet publike që parashikohen në këtë buxhet janë: Gjelbërim, Ndriçim, Mirëmbajtje Varrezash Publike, Dekor, Mirëmbajtje rrugë e trotuare.

Shpenzimet për Mirëmbajtjen e Varrezave Publike i pakësohen Bashkisë dhe kalojnë pranë Ndërmarjes Komunale. Sektori mbështetës kalon pranë burimeve njerëzore ( program 01110). Për shkak të këtij transferimi efektet financiare reflektohen në fondin e pagave për vitet 2026 – 2028. Kontrata e mirëmbajtjes së varrezave publike do të kryhet nga ndërmarja komunale, kontrata aktuale është në vlerë 4,195,089 lekë. Për vitin 2026 shpenzimet për këtë shërbim parashikohen 4,290,740 lekë. Shpenzimet e kësaj kontrate 4 vitet e fundit janë parashikuar si shpenzime operative. Në vitet 2026 – 2028 shpenzimet e mirëmbajtjes së varrezave publike janë detajuar në: shpenzime për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative.

PROGRAMI TRASHËGIMIA KULTURORE, EVENTET ARTISTIKE DHE KULTURORE (08220):

Në këtë program janë parashikuar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime (shtim i fondit të bibliotekës). Fondi i pagave për vitet 2026 – 2028 vjen në ulje për shkak se një sanitare kalon tek sektori mbështetës në programin 01110.

Institucionit të Qendrës Kulturore i bashkohet dhe Qendra Kulturore e Fëmijëve.

PROGRAMI ARSIMI BAZË DHE QKF (09120):

Shpenzimet e stafit dhe shpenzime operative për Qendrën Kulturore të Fëmijëve pakësohen tek Qendra Ekonomike e Arsimit dhe kalojnë pranë Qendrës Kulturore. Në llogaritjen e fondeve për paga është patur parasysh rritja e pagës minimale në masën 50 mijë lekë. Ulja e vlerës së investimeve vjen për shkak se

kontrata për rikonstruksionitn e shkollës Aleksandër Markaçini, e cila financohet edhe në vitin 2026, është lidhur më pak se vlera e parashikuar në buxhetin e vitit 2025.

Transferta ndaj FSHZH në shumën 1,210,882 lekë dhe 169,800 lekë shpenzime të tjera operative parashikohen në vitin 2026 për projektin "Rigjenerim i jetes artistiko kulturore duke promovuar praktika inovative te eficences energjitike".

## PROGRAMI I MBROJTJES SOCIALE (10430):

Parashikon trajtimin e familjeve në nevojë me ndihmë ekonomike, pagesa e paaftësisë për personat me aftësi të kufizuar (me fonde të buxhetit të shtetit) si dhe trajtimin e rasteve të veçanta, që do të bazohen në vlerësimin financiar të këtyre familjeve (trajtimi i tyre do të bëhet me fondet e bashkisë) duke kontribuar në rritjen e të ardhurave të familjes apo nxitjen e punësimit. Gjithashtu parashikohet që me fonde të bashkisë të trajtohen familje në nëvojë, me pako ushqimore.

Drejtoria e Sherbimeve Sociale ka parashikuar disa aktivitete te cilat korrespondojne me Ditët Ndërkombëtare të Sensibilizimit për grupe e çështje të ndryshme sociale si Dita Ndërkombëtare e Gruas, Dita Ndërkombëtare e Romëve, Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve Jetimë, Dita Ndërkombëtare e të Paaftëve.

Shpenzimet e parashikuara për këtë program:

Për NJMF, në tre vitet e ardhshme parashikohen, fonde për menaxhimin e rasteve si më poshtë:
Pagesa çerdhe/kopshte për fëmijët në risk:
Ky fond do të shërbejë për të mbështetur rreth 10 fëmijë nga familje shumë në nevojë dhe me problematika sociale me pagesën e çerdhes/kopshtit. Me këtë nismë ne duam që të nxisim/fuqizojmë prindërit e tyre që të punojnë dhe të kenë një vend të sigurtë për të lënë fëmijët.

-Mbështetja do të jetë për një periudhë nga 1 deri në 6 muaj, bazuar në vlerësimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve për çdo rast. Shpenzim për bashkëfinancim të projekteve të fituara, shpenzime gjyqësore etj. Fëmijet e mitur të braktisur (A.D dhe E.D), të strehuar në strehëz do të mbështeten me fonde 5 (pesë) mijë lekë në muaj për sejcilin. Pagesa do ti kryhet strehëzës (Qendra rinore motrat Venerini, Gjadër Lezhë).

Barazia Gjinore:

1. Drejtoria e Sherbimeve Sociale do të ofrojë suport për plotësimin e dokumentacionit (noterime, prokura, nxjerrje çertifikatash etj) në rast se do të paraqitet nevoja.
2. Sigurimin e transportit në rast se do të jetë e nevojshme që të referohet rasti në strehëza jashtë qytetit.
3. Akomodime 24 ose 48-orëshe (do të jenë në 3 banesat sociale të caktuara për këtë qellim) sipas rastit të personave të rrezikuar (gra të dhunuara) deri në dërgimin e tyre në qendra të specializuara.
4. Për nevoja emergjente jetësore ushqim, veshmbathje, dhe shërbime të tjera të dosmosdoshme.
5. Për shërbime mjeksore, nëse do të duhet të shpenzohet për medikamente.

Drejtoria e Shërbimeve Sociale do të ofrojë suport për plotësimin e dokumentacionit (noterime, prokura, nxjerrje çertifikatash etj) në rast se do të paraqitet nevoja.

Sigurimin e transportit në rast se do të jetë e nevojshme që të referohet rasti në strehëza jashtë qytetit.

Për akomodime të përkohshme, do të jenë në dispozicion 3 banesa sociale, sipas rastit të personave të rrezikuar (gra të dhunuara etj.,) deri në sistemimin e tyre në qendra të specializuara.
Për nevoja emergjente jetësore ushqim, veshmbathje, dhe shërbime të tjera të dosmosdoshme, për shërbime mjeksore, nëse do të duhet të shpenzohet për medikamente.

Pagesë në para me fondet e veta, për çdo rast, sipas vendimeve të Këshillit Bashkiak.
Drejtorisë së Shërbimit Social i është bashkuar edhe Qendra Ditore për Fëmijët me Aftësi të Kufizuar, shpenzimet për këtë qëllim në PBA, i pakësohen Qendrës Ekonomike të Arsimit dhe i shtohen Bashkisë.

Gjatë vitit 2025 është zbatuar projekti: "Përmirësim i shërbimeve dhe mirëqënies sociale në Bashkinë Kuçovë", ky projekt do të financohet Bashkia Kuçovë nga Ministria e Shëndetsisë e Mbrojtjes Sociale për vitet 2025-2027 dhe më pas do të financohet plotësisht nga Bashkia Kuçovë.

Ky projekt u vjen në ndihmë fëmijëve të Qendrës Ditore dhe personave të moshës së tretë nëpërmjet 3 punonjësve të punësuar me kontratë pranë kësaj qendre.

Shkurtohet një pozicion pune si specialist i Ndihmës Ekonomike.

Në këtë program parashikohen dhe shpenzimet e stafit dhe shpenzime operative për Çerdhet (shpenzime për ushqime, ngrohje, ndriçim, ujë telefon, materiale pastrimi, shpenzime për mirëmbajtje).
Për vitet në vijim parashikohet nje rritje e fondeve për ushqime për kopshtet dhe çerdhet. Në momentin e lidhjes së kontratës do të rishikohet dhe vlera e kuotës ushqimore.

-Gjatë vitit 2025 janë mbajtur 7 dëgjesa publike, pjesëmarrja në këto dëgjesa është 181 banorë. Dëgjesat publike janë mbajtur në të gjitha njësitë administrative.

Lidhur me projekt buxhetin për vitet 2026-2028, theksojmë se:

1. Për vitin 2026, 50% e buxhetit të përgjithshëm shkon për paga dhe sigurime shoqërore, 26% e buxhetit shkon për shpenzime operative, transferta tek institucione, transferta tek individë dhe fond rezerve dhe 24% e buxhetit shkon për investime.

2. Për vitin 2027, 51 % e buxhetit të përgjithshëm shkon për paga dhe sigurime shoqërore, 25% e buxhetit shkon për shpenzime operative, % transferta tek institucione, transferta tek individë dhe fond rezerve dhe 24% e buxhetit shkon për investime.

3. Për vitin 2028, 50% e buxhetit të përgjithshëm shkon për paga dhe sigurime shoqërore, 26% e buxhetit shkon për shpenzime operative, % transferta tek institucione, transferta tek individë dhe fond rezerve dhe 24% e buxhetit shkon për investime.

4. Shpenzimet e planifikuara për vitin 2027 janë 0.2% më të larta se parashikimi i shpenzimeve për vitin 2026. Shpenzimet e planifikuara për vitin 2028 janë 1.6% më të larta se parashikimi i shpenzimeve për vitin 2027.
5. Transferta specifike zë rreth 23.37% të buxhetit vjetor dhe përdoret kryesisht për paga dhe sigurime shoqërore.

Ngarkohen për zbatim Bashkia Kuçovë, Qendra Kulturore, Qendra Ekonomike e Arsimit dhe Ndërmarja Komunale.

Ky vendim u miratua me: 19 vota pro , 3 vota kundër, ________ abstenim të pranishëm 21 këshilltare.

( 7 këshilltarë nuk morën pjesë në votim.)

**KRYETAR I KESHILLIT BASHKIAK**

**Aleksandër ZIU**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KUÇOVË